



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-28/2008, dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-27/2008, nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,----- miraton këtë:

Projektet - V E N D I M

Për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital.

Neni 1

1.1 Në bazë të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025 nga Rezervat e projektit kapitale që duhet të buxhetohen në projektin kapital është shuma prej 200,000.00.00€ (180,000.00+20,000.00),e që në total i bie shuma prej; = **200,000.00€** si rezervë,e cila duhet të kaloj në kategorinë aktive të projekteve kapitale.

1.2 Shuma e lartshënuar do të transferohet- alokohet në këtë projekt kapitale që nuk i ka plotësuar kriteret sipas UA-Nr.04/2019 dhe UA-Nr.06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale e që tani konsiderojmë se janë plotësuar kërkesat e Udhëzimeve Administrative në fjalë.

Neni 2

Lista e projekteve kapitale që kalojnë nga Rezervat në projekte kapitale për vitin fiskal 2025.

Programi	Kodi i Programit	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	10-BKK 2025	21-THV 2025	Totali 2025
624180-Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia						
180120-Infrastruktura Rrugore-Suhareke						
180	18012	Projekt i RI	Blerja e auto fshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, traktor me pajisje përcjellëse për nevojat e Komunës.	180,000.00	20,000.00	200,000.00
Totali-Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia				180,000.00	20,000.00	200,000.00
TOTALI KOMUNAL :				180,000.00	20,000.00	200,000.00

Arsyetim

Transfer i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezervat (38) në kategorinë e shpenzimeve kapitale shuma prej =200,000.00€

Nga nën programi:

Infrastruktura Rrugore kodi i programit 10/624/18012), (38) shuma prej 180,000.00€, dhe 21/624/18012/38/ shuma prej 20,000.00€.

“Blerja e auto fshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, traktor me pajisje përcjellëse për nevojat e Komunës”, kodi i Ri projektit shuma prej (180,000.00€+20,000.00€)=200,000.00€.

Të gjitha rezervat nga fondi (38) janë ridestinuuar në projekte kapitale konform UA MF-NR 04/2019 dhe UA MF-NR 06/2019 të cilat projekte i plotësojnë kriteret përzgjedhëse për projekte kapitale dhe sipas vendimit të Kuvendit Komunal është bërë edhe ndryshimi i destinimit të rezervës në kategoritë ekonomike përkatëse konform planit kontabël dhe kodeve pesë shifrore si transfer/rialokim i Ri sipas njësisë buxhetore.

Projekti “Blerja e auto fshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, traktor me pajisje përcjellëse për nevojat e Komunës”, kodi i Ri projektit shuma prej (180,000.00€+20,000.00€)=200,000.00€, do i shtohet edhe shuma prej 200,000.00 euro si shtesë e projektit të Ri i cili projekt nuk është në tabelën 4.2. të listës së projekteve kapitale për vitin fiskal 2025.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendim shfuqizohet vendimi me numër të protokollit 01-Nr-016-12097 i datës 28.02.2025, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI